



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0290

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Bajram HA.Gashi B.I., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Komuna Suharek në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i impiantit për ujra të zeza në Dubravë - Ritender me numër të prokurimit 624-24-11350-5-2-1, me 17.06.2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE Bajram HA.Gashi B.I., me nr. 2025/0290, e datës 23.04.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i impiantit për ujra të zeza në Dubravë - Ritender me numër të prokurimit 624-24-11350-5-2-1.

2. Mbetet në fuqi B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të Komuna Suharek, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i impiantit për ujra të zeza në Dubravë - Ritender me numër të prokurimit 624-24-11350-5-2-1 .

3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s h e v e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 29.10.2024 Komuna Suharek., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i impiantit për ujra të zeza në Dubravë - Ritender me numër të prokurimit 624-24-11350-5-2-1.

Me 04.04.2025, AK (me të dhëna si më sipër) ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin (B58) e Autoritetit Kontraktues, ku ka shpërblyer me kontratë OE K-ING SH.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur, me llojin e kontratës punë, me vlerë të parashikuar të kontratës 190,000.00 euro.

Me 09.04.2025 OE Bajram HA.Gashi B.I., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Më 14.04.2025 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 23.04.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Bajram HA.Gashi B.I., me numër protokolli 2025/0290 lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i impiantit për ujra të zeza në Dubravë - Ritender me numër të prokurimit 624-24-11350-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Bajram HA. Gashi B.I., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi Ankimor 1

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Suharekës, në vendimin e saj të datës 22.04.2025, në vend që të trajtojë pretendimet tona ankimore siç kërkohet nga neni 108/A i Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), ka devijuar nga analiza ligjore dhe objektive, duke u marrë me çështje jashtë kontekstit të ankesës sonë. Ne si Operator Ekonomik kemi prezantuar prova dhe fakte konkrete që vërtetojnë përgjegjshmërinë e ofertës sonë. Në vend të shqyrtimit të tyre, AK ka dalë me komente të paarsyeshme dhe akuzon kompaninë tonë për “moslexim të shkresave”, apo komenton vendosjen e vulës në dokumentacion, ndërsa zyrtari i prokurimit i AK-së nuk i ka lexuar fare dispozitat përkatëse të LPP-së, duke vazhduar të nxjerrë shkresa në emër të Zyrës së Prokurimit pa asnjë shqetësim dhe duke abuzuar me dispozitat ligjore dhe gjendjen faktike.

Sipas Kapitullit VII të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, konkretisht neni 23 i LPP-së, një person mund të shërbejë si Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit vetëm nëse ka diplomë universitare dhe certifikatë valide të prokurimit të lëshuar në përputhje me nenin 25 të LPP-së. Zyrtari i AK – Komuna Suharekë nuk posedon një certifikatë valide, andaj të gjitha aktet e lëshuara prej tij janë juridikisht të pavlefshme (nule).

Kjo është e përforcuar edhe nga Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 52, i cili përcakton se një akt administrativ është i paligjshëm nëse është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një zyrtar kompetent.

Për pasojë, kërkojmë që kjo çështje të trajtohet me seriozitetin e duhur, pasi ne si kompani do të vazhdojmë me procedura të mëtejshme ligjore dhe pasoja juridike do të bien mbi të gjithë zyrtarët që kanë anashkaluar apo kanë shkelur në mënyrë të qëllimshme dispozitat ligjore.

Pretendimi Ankimor 2

Zyrtari “përgjegjës” i prokurimit të AK – Komuna Suharekë, edhe pse nuk ka autorizim të vlefshëm dhe veprimet e tij janë juridikisht nule, ka ndërmarrë vendime që përbëjnë shkelje të drejtëpërdrejta të ligjit. Ai ka synuar të eliminojë ofertën tonë në mënyrë të paarsyeshme, pavarësisht se ne kemi dorëzuar dëshmi të plota që mbulojnë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Në letrën standarde të datës 04.04.2025, AK ka deklaruar se më datë 13.03.2025 ka kërkuar sqarime mbi statusin e z. Idriz Seferaj si udhëheqës i punishtes, për shkak të një punësimi të mëparshëm të tij në një kompani tjetër, sipas ATK. Sipas AK-së, mungonte një vërtetim nga punëdhënësi i parë për punësimin primar të z. Seferaj.

Gjithashtu, si arsye të dytë të eliminimit, AK ka përmendur një “mos përputhje” për një faturë, ku thuhet se OE ka kërkuar pagesë në bankën NEB, ndërsa pagesa është realizuar në Raiffeisen Bank. Këto pretendime janë tërësisht të pabaza dhe paraqesin përpjekje të qarta për eliminim të padrejtë dhe për keqpërdorim të parasë publike.

Në realitet:

Z. Idriz Seferaj ka një kontratë bashkëpunimi të nënshkruar me kompaninë tonë për projektin në fjalë.

AK ka qenë në dijeni për statusin e tij dhe për kontratën tonë.

Ne kemi dorëzuar sqarimet përkatëse në platformën e-prokurimi dhe fizikisht te AK me numër protokolli, që dëshmojnë se z. Seferaj do të deklarohet si punëtor me punë primare në kompaninë tonë para fillimit të punës, në përputhje me legjislacionin tatimor dhe me kontratën e bashkëpunimit.

Që nga dhjetori 2024, ne jemi deklaruar si punëdhënësi sekondar për z. Seferaj.

AK, në vend që të trajtojë këtë dokumentacion, e ka anashkaluar dhe manipuluar procesin e rivlerësimit, duke tentuar të paraqesë arsyetime të paqëndrueshme për eliminimin tonë.

Madje, kemi edhe dëshmi të kontratave të tjera me të njëjtën komunë, të lidhura me të njëjtën formë bashkëpunimi dhe për të njëjtin inxhinier, ku nuk është kërkuar asnjë sqarim i tillë. P.sh., kontratat me numër të prokurimit 624-25-415-521 dhe 624-25-04-521 të datës 20.03.2025, dëshmojnë trajtim të pabarabartë dhe diskriminues të ofertës sonë në këtë procedurë të fundit.

Kjo sjellje e AK-së përbën një shkelje të rëndë të barazisë së trajtimit të operatorëve ekonomikë dhe krijon baza për përgjegjësi ligjore ndaj zyrtarëve përgjegjës.

Masa të ndërmarra

Ne, si Operator Ekonomik ankues – Bajram Ha. Gashi BI, kemi:

Informuar Zyrën Kombëtare të Auditimit

Informuar Kryetarin e Komunës së Suharekës

Deklaruar se pas përfundimit të procedurës në OSHP, lënda do të dorëzohet në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe në instanca të tjera ligjzbatuese.

Pretendimi Ankimor 3

Arsyeja tjetër e eliminimit tonë, e lidhur me faturimin ndaj Alpe SHPK dhe mënyrën e pagesës, siç përshkruhet në letrën standarde të AK-së të datës 04.04.2025, është absurde dhe komike.

Roli i Autoritetit Kontraktues është vlerësimi i ofertave në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit. Çështja e pagesave rregullohet nga ligje të tjera, dhe ne si kompani u përgjigjemi institucioneve kompetente financiare, jo AK-së.

Ju, si AK, keni kërkuar që dokumentacioni i pagesave të prezantohet në formën origjinale, gjë të cilën ne e kemi bërë. Ju, së bashku me komisionin vlerësues, i keni ekzaminuar ato dokumente “me llupë” dhe keni dalë me përfundimin se pagesa është realizuar gjoja gabimisht. Kjo është një tejkalim flagrant i kompetencave tuaja, pasi sistemi financiar dhe bankar në Kosovë rregullohet nga legjislacion i veçantë dhe nuk ka qenë asnjëherë kriter i kësaj procedure prokurimi, e as që mund të jetë.

Injoranca e AK-së e shfaqur me këto komente dhe vlerësime të pavenda është thellësisht shqetësuese dhe dëshmon për një tendencë të qëllimshme për të na eliminuar me çdo kusht. Këto veprime përbëjnë shkelje të rënda të parimeve të prokurimit publik dhe tregojnë mungesë të plotë të etikës profesionale.

Mënyra e pagesës nuk ka qenë dhe nuk mund të jetë kërkesë kualifikuese në dosjen e tenderit. Ndërkohë që vetë pagesa është realizuar me sukses, siç vërtetohet me dëshminë për transferin e suksesshëm për Alpe SHPK.

Pretendimi Ankimor 4

Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka paraqitur në ofertë një listë të pajisjeve teknike, ku është përcaktuar vetëm vlera e kapacitetit motorik, por jo edhe kapacitetet tjera të kërkuara nga dosja e tenderit, siç është pesha e ngarkesës.

Nga librezat e qarkullimit rrugor, qartë shihet se kapacitetet e kamionëve të ofruar nuk përmbushin kërkesat e vendosura në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë. Po ashtu, OE i rekomanduar nuk ka përdorur Aneksin 7 të dosjes së tenderit, ashtu siç ka qenë e kërkuar nga AK – Komuna Suharekë.

Në Dosjen e Tenderit dhe në Aneksin 7 është kërkuar specifikisht që të tregohet kapaciteti minimal dhe maksimal i ngarkesës së lejuar për pajisjet. OE i propozuar nuk e dëshmon këtë për pajisjet kyçe, përfshirë:

Kamion transportues kipper mbi 10 m³

Kamion transportues kipper 6-8 ton

Asnjëri nga kamionët e prezantuar nuk përmbush kapacitetin e ngarkesës mbi 10 ton, siç është kërkuar. Kjo do të thotë se OE është i papërgjegjshëm, ndërsa AK, përmes komisionit vlerësues, ka rekomanduar padrejtësisht dhënien e kontratës një OE-je që nuk përmbush kërkesat bazë të tenderit.

Pretendimi Ankimor 5

OE i propozuar për dhënie të kontratës ka dorëzuar deklaratën nën betim e cila:

Nuk përmban titullin e aktivitetit të prokurimit

Nuk përmban numrin e aktivitetit të prokurimit

Kjo deklaratë, sipas Ligjit për Prokurimin Publik, është dokumenti bazë dhe kryesor i çdo procedure prokurimi. Neni 10 i Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (UOPP) përcakton qartë se nëse një deklaratë e tillë nuk dorëzohet ose nuk përmbush kushtet ligjore, oferta duhet të refuzohet automatikisht.

Në këtë rast, AK ka anashkaluar qëllimisht këtë mangësi, me qëllim që të lidhë kontratë me OE-në e parapëlqyer, pavarësisht:

Mospërmbushjes së kriterëve ligjore

Kostove më të larta

Përfitimeve të individëve të caktuar brenda AK-së

Ky veprim është një shkelje e rëndë e ligjit dhe tregon për favorizim të hapur dhe abuzim me parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Pretendimi Ankimor 6

OSHP – Paneli Shqyrtues, për këtë procedurë të prokurimit, ka nxjerrë më datë 18.02.2025 vendimin me nr. OSHP: 2024/1255, ku ka kërkuar rivlerësim të ofertave.

AK-ja, në kundërshtim me këtë vendim dhe me nenin 40.3 të LPP-së, ka konsumuar rreth 50 ditë për rivlerësim, ndonëse afati ligjor është jo më shumë se 10 ditë sipas vendimit të OSHP-së dhe 30 ditë sipas ligjit për vlerësimin e ofertave.

Kjo vonesë e qëllimshme është pjesë e skemës për eliminimin e ofertës sonë dhe për favorizimin e OE-së së parapëlqyer. Për këtë arsye, ne do të kërkojmë përgjegjësi ligjore për të gjithë zyrtarët përkatës.

Të gjitha këto veprime përbëjnë shkelje të rëndë ligjore, duke përfshirë:

Nenin 6, 7, 51, 59, dhe 69 të LPP-së

Nenin 97 të Rregullores nr. 001/2022, që ndalon favorizimin dhe diskriminimin, duke i cilësuar ato si shkelje të rënda të ligjit.

Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim:

Pretendimi 1 – Nuk qëndron

Zyrtari i prokurimit në Komunën e Suharekës është punësuar në këtë pozitë përmes konkursit të rregullt dhe asnjë dispozitë e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) nuk ndalon që zyrtari përgjegjës i prokurimit apo zyrtarë të tjerë të punësuar të dërgojnë letra standarde për sqarime, sipas kërkesës së Komisionit të Vlerësimit.

Pretendimi 2 – Nuk qëndron

Me datë 13.03.2025, AK ka dërguar letër standarde për sqarim lidhur me vendimin për caktimin e udhëheqësit të vendndërtimit, z. Idriz Sefcraj, i cili është i punësuar me punë primare në një kompani tjetër, sipas verifikimit nga ATK.

Si rrjedhojë, AK ka zbatuar nenin 52, paragrafi 7 i LPP-së, i cili kërkon që për menaxherin e projektit të ofrohet dëshmi shtesë, përkatësisht vërtetim nga punëdhënësi, që vërteton se gjatë periudhës së implementimit të kontratës, ai është i liruar nga detyra e tij primare, meqë duhet të jetë i pranishëm në vendpunishte gjatë gjithë kohës.

OE ka dhënë një përgjigje sipas kërkesës së AK-së, por ka dështuar të sjellë vërtetimin nga punëdhënësi primar për inxhinierin në fjalë. Zyrtari i Prokurimit ka dërguar email te inxhinieri në fjalë, duke kërkuar konfirmim nëse ai është i gatshëm të tërhiqet nga puna primare dhe të udhëheqë projektin nga fillimi deri në përfundim.

Me datë 18.03.2025, AK ka pranuar përgjigje nga inxhinieri i lartpërmendur, i cili nuk është pajtuar të tërhiqet nga puna primare në biznesin ku është pronar.

Pretendimi 3 – Nuk qëndron

Përkundrazi, qëndron e kundërta e pretendimit tuaj (që e cilësoni si “komik”) lidhur me faturën në fjalë. Komisioni Vlerësues ka vërtetuar se dokumentet e sjella nga OE nuk korrespondojnë me dokumentet e ngarkuara në sistem.

Konkretisht, vërtetimi i pagesës i dorëzuar nuk përputhet me atë që është prezantuar në Dosjen e Tenderit. Vula e dokumentit nuk ndodhet në pozitën identike, gjë që dëshmon se nuk bëhet fjalë për të njëjtin dokument, duke ngritur dyshime për autenticitetin e dëshmisë së ofruar

Pretendimi 4 – Nuk qëndron

Pretendimi juaj nuk qëndron, pasi vërehet qartë që si OE jeni të pakënaqur me vendimin e AK-së dhe nuk e keni marrë parasysh mendimin dhe rekomandimin e ekspertit shqyrtues të këtij aktiviteti.

Në vendimin e OSHP-së me numër 2024/1255, ankesa juaj lidhur me këtë pikë është konsideruar e pabazuar dhe është refuzuar nga paneli shqyrtues.

Pretendimi 5 – Nuk qëndron

Edhe ky pretendim nuk qëndron, pasi kërkesa juaj për rishqyrtim mbi këtë çështje tregon qartë se nuk keni lexuar me kujdes ekspertizën për këtë aktivitet dhe as vendimin e OSHP-së nr. 2024/1255, ku ky pretendim është trajtuar dhe konsideruar si i pabazuar.

Pretendimi 6 – Nuk qëndron

Pas pranimit të vendimit nga OSHP-ja, Autoriteti Kontraktues ka formuar Komisionin e Ri të Vlerësimit për këtë aktivitet me datë 20.02.2025, për t'u marrë me rivlerësimin sipas urdhëresës së panelit.

Duhet marrë parasysh që anëtarët e komisionit të vlerësimit, përveç punës së tyre primare në institucion, janë të angazhuar edhe në komisione të ndryshme të caktuara nga ZKA, ndaj procesi është realizuar brenda mundësive operacionale, në përputhje me praktikën administrative

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 24.04.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0290, ndërsa me datë 14.04.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0290, me rekomandimet si në vijim:
Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar lidhur me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa nuk OE është pajtuar lidhur me mendimin e ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e Bajram HA.Gashi B.I., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0290 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin nr. 1.

OE “Bajram Ha Gashi B.I pretendon se A.K., Komuna e Suharekës nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së .

Ekspertja thekson se ndër të tjera qëllim i këtij neni është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se duhet të trajtojnë të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit .

Pretendimi i OE ankues ndër të tjera , se AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së sepse me rastin e vlerësimit nuk nuk na ka trajtuar ne menyre te barabartë sepse i njeiti pretendon se janë aplikuar standarde te dyfishta duke kerkua sqarime per Injhinierin me te cilin ka lidhur kontratë per kete projekt duke kerkuar deshmi se i njeiti do te lirohet nga puna primare nese ju ipet kontrata,edhe pse ne i kemi dhenë pergjigjeje permes letres standarde se :z.Seferaj para nenshkrimit te kontrates do te deklarohet tek kompania jonë me punë primare dhe si i tillë do te mbetet deri ne realizimin e projektit duke u bazuar ne ligjet ne fuqi dhe rregullat e ATK-së dhe kushteve te prezentuara ne kontraten e prezentuar ne oferten .

I njeiti thekson se ka edhe kontrata me te njeitin AK me te njeitin injhinier me te njeitat kushte dhe asnjehere nuk ishte kontestuese si ne kete rast .

Ekspertja sqaron se sa i perket pretendimit të OE ankues ,i njeiti pretendim është i bazuar sepse AK ka kerkua dhe ka pranua sqarime per injhinierin ne fjalë ndersa qendron pretendimi i OE ankues se ne NJK dhe DT nuk ishte parapare qe injhinieri te qendroj tërë kohen ne vendpunishte , ma gjeresisht do të gjeni pergjigjejet te pretendimi perkates e qe nderlidhet edhe me këtë dispozitë

Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuarë.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2 dhe 3.

OE “Bajram Ha Gashi B.I pretendon se A.K., Komuna e Suharekës nuk e ka respektuar neninn 52 dhe 56 të LPP-së .

Ekspertja thekson se ndër të tjera qellim i këtij neni është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet të vendosen kriteret për dhenjen e kontratës ndersa paragrafi 7 i kesajë dispozite ka per qellim që në rast të dyshimit per qdo informacion te dorezuar nga operatori ekonomik ,Ak duhet të kryejë një kontrollë efektive të informatave dhe dokumentacionit .

Gjithashtu ekspertja sqaron se ndër te tjera qellimi i nenit 56 te LPP-së janë te udhezohen autoritetet kontraktuese mbi dispozitat e pergjitheshme mbi perzgjedhjen e pjesmarresve dhe dhenien e kontratave ,ku ne paragrafin tre te ketij neni sakesohet se :

3.Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

OE ankues ndër të tjera pretendon se AK ka shkelur nenit 52 dhe 56 të LPP-së

Ekspertja sqaron se Autoriteti Kontraktues ka kerkua informacion per injhinierin i cili nga OE ankues është caktuar udheheqes i vendtimit dhe per te njeitin OE ankues ka dhenë pergjigjeje duke deklaruar-sqaruar se :z.Seferaj para nenshkrimit te kontrates do te deklarohet tek kompania jonë me punë primare dhe si i tillë do te mbetet deri ne realizimin e projektit duke u bazuar ne ligjet ne fuqi dhe rregullat e ATK-së dhe kushteve te prezentuara ne kontraten e prezentuar ne oferten .

Ekspertja sqaron se ky sqarim do duhet te ishte i pranueshëm per AK sepse me me NJK dhe DT siq thekson OE ankues nuk ishte paraparë qe Injhinieri ne fjalë te ishte prezent gjat gjithë kohes

ne vendpunishte ,andaj edhe vlerësimi do duhet behej ne harmoni me kriteret e parapara me NJK dhe DT dhe konsideroj se kërkesa apo pyetjet e drejtuara nga AK pertej OE ankues nuk ishin te nevojshme sepse per inxhinierin ne fjalë është pergjegjes OE ankues si kontraktor i mundeshem i ketij aktiviteti te prokurimit,sepse OE ankues është apo do te ishte pundhënës i Inxhinierit ne fjalë e jo Autoriteti Kontraktues sepse autoriteti Kontraktues do te hynte ne marrdhënje kontraktuale me OE ankues si ofertues dhe i njeiti OE do te ishte pergjegjes per implementimin e kontrates e jo personi fizik siq ishte ingjineri ne fjalë ,sqarim ma i detajuar edhe nese një inxhinier si menaxher i projektit lendohet ne punë apo mundë edhe të i shkeputet kontrata e punes,apo edhe mund të vdes prapsepap pergjegjes per implementimin e kontrates është Operatori Ekonomik i cili duhet te bej zavendesimet per inxhinierin me kualifikime siq jane parpare ,pra konsideroj se OE ankues i ka plotesuar kriteret e parapara me NJK dhe DT dhe gjat kërkeses per sqarime ka dhenë sqarime te mjaftueshme ne harmoni me kërkesat e parara me NJK dhe DT dhe konsideroj se pa te drejtë është eliminuar .

Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuarë.

Përgjigje në Pretendimin nr. 4 dhe pretendimi nr. 5.

OE “Bajram Ha Gashi B.I pretendon se A.K., Komuna e Suharekës nuk e ka respektuar nenin 59 dhe 69 të LPP-së.

Ekspertja thekson se nder te tjera qellim i nenit 59 te LPP-së,është ti udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet të bëhet Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahassimi i tenderëve ,fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të vlerësimit,i cili pasi i ka vleresuarë ofertat e pranuar ka dhënë rekomandim dhe i njeiti rekomandim është aprovuar nga udheheqesi i prokurimit,pas vendimit te OSHP-së AK ka berë vlerësim edhe pse i ka kaluar afatin e paraparë kjo shkelje është faktike por per te njejten AK ka dhenë sqarime te arsyeshme se antaret e komisioni ishin te zenë edhe me aktivitete te tjera dhe nuk kan pasur mundesi ta permyllin ma shpejt ,ndersa kjo konsideroj se nuk ka ndonjë ndikim ne rezultatin final.

Ndërsa qellimi i nenit 69 është te ti udhëzojë autoritetet kontraktuese lidhur me kriteret minimal te kerkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit se te njejtat duhet të permbushen dhe gjatë procesit të vlerësimit duhet të respektohen nga komisioni i vlerësimit perkatesisht nga autoriteti kontraktues .

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar informacion per ingjinerin i cili nga OE ankues është caktuar udheheqes i vendertimit

OE ankues ju ka pergjigjur kërkeses dhe ka dhenë sqarime ,sqarimin ma gjeresisht e gjeni ne pretendimin paraprak 2 dhe 3 te ketij raporti.

Ekspertja sqaron se Autoriteti Kontraktues me rastine vlerësimit ka pasur te drejtë te luajë rol aktiv dhe te kerkojë sqarime per punen primare dhe te kerkoj informacion nga Ofertuesi per kohen e ingjinerit i cili ishte dikun tjeter i punsuar me pune primare ,mirëpo pas pranimi te pergjigjejes do duhet ta pranonte sqarimin e OE tani ankues sepse i njeiti do duhet ta kishte parasysh se po kerkon sqarime dhe sqarimet e dhena ishin ne harmoni me kërkesat e AK-së,duke pasur parasysh se kërkesa per udheheqes i vendertimit si puna primare dhe sekondare askund nuk ishte permendur me dosjen e tenderit,si deshmi ishte kerkuar „Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja me punëdhënësin për angazhim në këtë projekt”andaj edhe qendron pretendimi i OE ankues .

OE ankues pretendon se pa te drejt është eliminuar per nje fatur se ka pasur te behet pagesa ne NLB ndersa e njejta ka ofruar pagesen e berë ne Rajfajzen Bank .

Ekspertja sqaron se me dosjen e tenderit nuk ishte parapar kriteri siq parashihet me RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar) perkatsisht piken ii te nenit 25.16 të „kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë me dëshmi të pagesës nga banka”

Sqarim : pra kriteri me ngjyrë bold është parapare me rregulloren e lartpermendur qe tani është ne fuqi ,por vlen te theksohet se ky kriter nuk ishte vendosur me dosjen e tenderit dhe dallimi me kriterin e parapare me dosjen e tenderit është se me kriterin paraprak e qe ishte ne dosjen e tenderit deshmit e pageses nga banka fare nuk ishin paraparë andaj edhe vleresimi do duhej te behej me kriteret e parapara me dosjen e tenderit sepse ashtu ishte nisur procedura dhe me te njejtat kritere edhe do duhej te behej vleresimi andaj konsideroj se qendron pretendimi i OE ankues .

Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuarë.

Pretendimi i OE ankues per oferten e OE te shpallur fitues :

OE ankues pretendon se OE i shpallur fitues nuk ka dorezuar: Listen siq ishte paraparë me aneksin 7 te DT .

Ekspertja sqaron se nuk qendron pretendimi i OE ankues sepse OE i shpallur fitues ka dorezuar listen makinerisë qe posedon vetem se e njejta listë ka te dhëna ma teper se sa janë kerkuar me aneksin 7 të DT.

OE ankues pretendon se OE i shpallur fitues nuk ka dorezuar Kamion transportues kiper mbi 10m3

Ekspertja sqaron se ky pretendim qendron si pjeserisht i bazuar sepse OE i shpallur fitues ne listen e makineris ka ofruar kete kamion por per te njejtin nuk e ka cekur se sa është gjatesia e tij por e ka specifikuar vetem tonazhen andaj me rastin e rivleresimit per te njejtin mundë te kerkohen informacion shtesë bazuar ne nenin 59 dhe 72 të LPP-së dhe per te njejtin kriter ishte konstatuar edhe me vendimin paraprak te OSHP-së me nr.2024/1255 te dates 18.02.2025 pra AK nuk ka kerkua sqarime apo ma drejtë te sqarojm se ne platformen e e-prokurimit nuk shihet ndonje kerkesë per sqarime per ketë kriter.

Pra nga ana e AK-së nuk është respektuar vendimi i OSHP-së me nr.2024/1255 i dates 18.02.2025.

Andaj Ekspertja sqaron se pretendimi është i bazuar .

Pretendimi tjetër per :

1.Kamion transportues kiper 6-8 ton

Ekspertja sqaron se nuk qendron pretendimi sepse ne listen e pajisjeve OE i shpallur fitues ka prezentuar:

Posicioni 2 dhe 3 ne tabel e listes se makinerise :

2. Kamion /Truck Kiper 01/260-MT 7.5 ton viti 2001 Pronat ,Man L 2000

3. Kaomion /Truck Kiper 01/994-MO 7.5 ton viti 1996 Pronat ,Mercedes Benz Atego 815

AK ka kerkuar kamion 6 deri 8 ton OE ka sjellur dy me tonazh 7.5 ton e qe janë brenda limiteve te kerkuara .

Edhe per ketë pretendim ishte vendosur me vendimin e OSHP-së me nr.2024/1255 te dates 18.02.2025 se i njejt pretendim nuk qendron.

Andaj , Ekspertja sqaron se ky pretendim është i pa bazuar

Pretendimi tjetër për :

OE ankues pretendon se OE i shpallur fitues nuk ka dorezuar Deklaraten nen betim e cila është e mangët ne elementet e rendesishme si nuk permban titullin e aktivitetit te prokurimit dhe numrin e aktivitetit te prokurimit :

Ekspertja sqaron se keto dy elemente nuk i permban deklarata nenë betim dhe e njejt as ne dosjen e pregaditur nga AK nuk i permban keto elemente andaj konsideroj se Ofertuesi e ka plotesuar dhe vulosur deklaraten nen betim me te dhenat e kerkuara brenda ketij aneksi.

Edhe per ketë pretendim ishte vendosur me vendimin e OSHP-së me nr.2024/1255 te dates 18.02.2025 se i njejt pretendim nuk qendron.

Andaj Ekspertja sqaron se nuk qendron pretendimi i OE ankues .

Përgjigje në Pretendimin nr. 6.

OE “Bajram Ha Gashi B.I pretendon se A.K., Komuna e Suharekës nuk e ka respektuar nenin 108/A të LPP-së

Ekspertja thekson se ndërë të tjera qellim i ketij neni është ti udhëzojë autoritetet kontraktuese për zgjidhje preliminare të mosmarrveshjeve .

OE ankues ndër të tjera pretendon se janë shkelur edhe dispozitat e nenit 108/A te LPP-së dhe neni 97 te Rregullores ne fuqi qe hyjn shkelet e renda ,sepse pretendimi per kamionet nuk është shqyrtuar .

Ekspertja thekson se nuk qendron pretendimi sepse ne vendimin e nxirrë nga AK lidhur me kerkesen per rishqyrtim ka dhenë pergjigjeje e sa i perket asjaj se zyrtari pergjegjes i prokurimit nuk ka pergaditje profesionale per mbajtjen e kesaj pozite është nëne kompetencen e organeve te tjera ,ndersa menyra e trjtimit te pretendimeve është relative sikurse që është edhe perpilimi i pretendimeve ankimore relative .

Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i impiantit për ujra të zeza në Dubravë - Ritender me numër të prokurimit 624-24-11350-5-2-1.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovet si pjesërisht e bazuar, mirëpo nuk mund ta mbështet raportin e ekspertit shqyrtues që lënda të kthehet në rivlerësim ngase sipas te gjeturave ne këtë procedur i elaboron si në vijim.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka respektuar vendimin me nr OSHP: 2024/1255 ku dhe ka kërkuar që AK-ne ka kthej lëdën në Rivlerësimit të ofertave ku AK -ja sipas vendimit ka aplikuar nenin 52.7 të LPP-së duke kryer një kontroll efektive të informatave dhe dokumentacionit të tenderit, si dhe nenin 72 të LPP-së duke kërkuar nga OE ankues sqarime lidhur me Inxhinjerin ku dihet që sipas NJK dhe DT-së Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës : Fillon në ditën e nënshkrimit të kontratës dhe përfundon pas 12 muajve. Nga të gjeturat në platformë elektronike e-prokurimit për këtë procedur AK-ja ka kërkuar sqarime tek OE ankues lidhur me ofrimin e deshmive që Inxhinjeri I.S te cilen e ka caktuar si Udhëheqes i Punishtës për këtë projekt i cili është 12 muaj kalendarik (1 vitë) dhe me qen se ka punë primare diku tjetër na ofroni deshmë që ky inxhinjer do të jetë i pranishëm në vendpunishte për çka edhe në NJK dhe DT tek kërkesat mbi mundësitë teknike/ profesionale është kërkuar Udhëheqësi i vendndërtimit– Një (1) Inxhinjer i diplomuar i ndërtimtarisë O.E. duhet të caktoj me vendim Udhëheqësin e vendndërtimit për këtë projekt mirëpo ne përgjigjet ne sqarime të kërkuara gjatë Rivlerësimit të ofertave nga AK-ja OE ankues nuk ka aritur të ofroj asnjë deshmë vetëm është thirrur në parakontraten e ofruar ne ofertë . Poashtu për të vërtetuar saktësinë se AK-ja ka kryer kontrollin efektive të informatave sikurse parashihet në nenin 52.7 të LPP-se ku ne përgjigjen për rishqyrim (Vendimi i AK-se), citohet se kemi kontaktuar përmes e-mailit me inxhinjerin në fjalë se po ky inxhinjer është deklaruar që nuk mund ta leshoj punën primare, Për të vërtetuar saktësinë e asaj që është përshkruar në Vendimin e AK-se (përgjigjen në Kërkesën për Rishqyrtim) , OSHP me datën 11.06.2025, i u është drejtuar AK-se duke kërkuar deshmë lidhur me përgjigjen e ofruar nga ky inxhinjer, Paneli Shqyrtues vlerëson duke ditur se qëllimi i kërkesës së parashtruar udhëheqësit në vendpunishte për kontratë 12 muaj gjatë implementimit të kontratës për çka kanë lidhur para-kontratë në mes të OE ankues dhe inxhinjerit I.S lidhur me këto aktivitete të prokurimit dhe në rast se inxhinjeri deklarohet që nuk mund ta le vendin time punën primare ku orani i punës është 08 ore punë , atëherë si realizohet kontrata në pamundësi të inxhinjerit, cili është qëllimi i këtij inxhinjeri ku sipas përgjigjes të ofruar nga AK-Komuna e Suharekës (data 11.06.2025) kanë ofruar deshmë nga inxhinjeri i prezentuar nga OE ankues 9i cili është deklaruar se citoj *“nuk pajtohem të hiqem nga puna primare në biznesin të cilen jam edhe vetë pronar , poashtu jam i angazhuar me disa kontrata tjera të cilen jam i angazhuar me punën time”* .Duke mos u deklaruar që qëndroj prapa parakontrates se nënshkruar në mes të dy palëve nga e gjithë kjo situatë kjo nënkupton që vetë inxhinjeri të cilen ka prezentuar OE ankues ka hëk dorë nga parakontrata e ofruar ne ofertë.

Poashtu Paneli Shqyrtues lidhur me faturat për çka është eliminuar dhe ka qenë pretendim ankimor një faturë se ka pasur të bëhet pagesa në NLB ndërsa e njëjta ka ofruar pagesën e bërë në Raiffeisen Bank sipas B58, formularit mbi eliminimin e OE ankues. Fatura e dorëzura fizikisht nga banka Raiffeisen vërehet ndryshimet nga ajo e prezentuar në ofertë (destinimi i vulave zyrtare të bankës)

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues nga të gjeturat në këtë procedurë dhe përgjigja e ofruar nga AK-ja (korespondimi i AK-së me inxhinierin) si dhe faturat ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i impiantit për ujë të zeza në Dubravë - Ritender me numër të prokurimit 624-24-11350-5-2-1.

Poashtu, Paneli Shqyrtues vëren se në këtë procedurë vlera e parashikuar është 190,000.00 Euro ndërsa çmimet e ofruara sipas procedurës me poentim janë mbi vlerën e parashikuar. Ku PSH kërkon nga AK që të jenë të vëmendshëm mos të futen në obligime në rast se nuk kanë mjete buxhetore.

Paneli Shqyrtues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të sigurojë integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situatat e tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - BAJRAM HA.GASHI B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: